



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 3662 prot.

Ballsh më, 24.07.2023

VENDIM

Nr. 35 Datë 24.07.2023

**“PËR
PAGESËN E VLERËS SË QIRASË FAMILJES SË Z. GRAMOS MUÇAJ, BANOR I
FSHATIT VISOKË, NJËSIA ADMINISTRATIVE QENDËR, BASHKIA
MALLAKASTËR”**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3, gërma d, Ligjit Nr. 22/2018, “Për strehimin social”, evidentimeve të kryera nga ana e strukturave të Bashkisë Mallakastër (Sektori i Mbrojtjes Civile) në lidhje me dëmtimin e banesës së qytetarit, si dhe kërkesave të paraqitura pranë Bashkisë Mallakastër datë 14.04.2023 dhe 16.06.2023,

VENDOSI

1. Pagesen e vlerës së qirase për familjen e **Z. Gramos Muçaj**, banor i fshatit Visokë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Mallakastër, familje e cila ndodhet në kushte të vështira financiare dhe banesa është e dëmtuar. Vlera e qirasë e propozuar është deri në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj për një periudhë 1 vjeçare (12 muaj), me të drejtë rinovimi për një periudhë 1-vjeçare (në rast disponibiliteti financiar të Bashkisë Mallakastër).
2. Shpenzimet e vlerave të qirasë do të mbulohen nga të ardhurat e Bashkisë Mallakastër.
3. Ky vendim shoqërohet me relacion shpjegues.
4. Ky vendim hynë në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes

KRYETAR

Nexhmî Sullaj

